REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 425/25 Dt. 15.07.2025

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) të Rregullores (QRK) nr. 06/2023 për Kompensimin për Udhëtime Zyrtare dhe Shpenzime të Përfaqësimit dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Levent Bush, zëvendëskryesues i Kuvendit të Komunës së Prizrenit, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
Për lejimin e udhëtimit zyrtar

1. Miratohet kërkesa e Levent Bush, zëvendëskryesues i Kuvendit të Komunës së Prizrenit, bazuar në ftesën e Kryetarit të Bordit Drejtues të YAFEMSPOR, për lejimin e udhëtimit zyrtar me qëllim të pjesëmarrjes në Festivalin e 28- të të Kulturës së Fiseve Turke, e cila që ka për qëllim njohjen dhe bashkimin kulturor të të gjitha fiseve turke dhe komunitetet të lidhura në mbarë botën. Festivali do të mbahet nga data 17 korrik 2025 deri me 23 korrik 2025, në Yalova të Republikës së Turqisë, kështu që, për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar, pagesa e shpenzimeve të udhëtimit dhe pagesa e mëditjeve për të lartcekurin, konform, akteve ligjore për Udhëtimet Zyrtare.

2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës - pozicioni i subvencioneve dhe transferëve të Zyrës së Kryetarit dhe mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.

3. Obligohet Drejtoria për Ekonomi dhe Financa për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Të lartcekurit,
- Arkivës së Kryetarit.